

KONTRATË SHITJE
E PJESEMARRJES SË KAPITALIT TË SHOQËRISË
“PANDA CONSULTING” SHPK

Lidhur sot, në Tiranë, më 31/10/2018, midis paleve si ne vijim:

Shitesi: z. Lejdon Sefa, shtetas shqiptar, i biri i Armandit, lindur më 09.04.1991, ne Lushnje dhe banues në Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtës i dokumentit te identifikimit me nr. J10409114U.

dhe

Bleresi: z. Hysni Llanaj, shtetas shqiptar, i biri i Yllit, lindur më 27.10.1986, ne Elbasan dhe banues në Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtës i dokumentit te identifikimit me nr. I61027056E

Baza Ligjore: Neni 73, i ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për shoqëritë tregtare”, Kodi Civil i R. Sh, neni 705 e vijues,

Palet ose perfaqesuesit e tyre jane madhore dhe me zotesi te plote juridike e per te vepruar dhe gezojne te gjitha cilesite dhe kompetencat per te realizuar kete kontrate. Keto pale ne perputhje me vullnetin e tyre te lire dhe te plote dhe ne baze te Vendimit te Asamblese se Ortakeve, vendosin nëpërmjet kesaj kontrate te transferojne pjesemarrjen ne kapitalin e shoqerise, se bashku me te drejtat dhe detyrimet e lidhura me kete pjesëmarrje.

Neni 1 - Shitja e 50% te pjesemarrjes ne kapitalin themeltar të shoqërisë

Objekt i kesaj kontrate shitblerje eshte shitja nga Shitesi tek Bleresi i 50% te pjesemarrjes ne kapitalin e shoqerise Panda Consulting shpk, qe zoteron Shitesi, Lejdon Sefa si dhe te drejtave reale si dhe interesave pasurore te lidhura me kete pjesemarrje, te drejta keto qe mund te vijne tani ose ne te ardhmen, duke njohur bleresin, z. Hysni Llanaj, si pronar ligjor te kesaj pjesemarrje, si dhe blerja e 50% te kapitalit te shoqerise Panda Consulting shpk, nga Bleresi, si dhe cdo lloj te drejte reale, si dhe interesat pasurore te lidhura me kete pjesemarrje ne kapital, te drejta keto qe mund te vine tani ose ne te ardhmen duke njohur bleresin si te vetmin pronar ligjor.

Neni 2 - Çmimi i shitjes

50% e pjesemarrjes se zoteruar nga ortaku Lejdon Sefa i shiten z. Hysni Llanaj per vleren prej 50 leke (pesedhete), çmim i cili eshte shlyer teresisht midis paleve, te cilet e konfirmojne me nenshkrimin e kesaj kontrate.

Neni 3 - Të drejtat dhe detyrimet e blerësve

1. Blerësi detyrohet të marre në dorëzim në rregull me inventare cdo aset të shoqërisë, si dhe të gjitha faturat që provojnë të drejtat dhe detyrimet që ka shoqëria ndaj të tretëve.
2. Bleresi ka të drejtë të arkëtojë të hyrat e paarkëtuara, si dhe detyrohet të shlyejë cdo detyrim të shoqërisë ndaj të tretëve te detajuara keto ne proces verbalet e pranuar dhe te nenshkruara nga te dyja palet para nenshkrimin te kesaj kontrate.

3. Këtë kontratë shitje te pjesemarrjes, bashke me dokumentacionin perkates, t'a depozitojë në Regjistrin Tregtar pranë QKB Tiranë, si dhe të njoftojë ndryshimin e pronësisë mbi shoqërinë: në Zyrën e tatim taksave qendrore dhe vendore, në ISKSH dhe kudo qe mund te kerkoet ne baze te ligjit.

Neni 4 - Të drejtat dhe detyrimet e shitësit

Shitesi deklaron se ai zoteron pjesemarrjen ne kapitalin e shoqerise, objekt i kesaj kontrate dhe gezon te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe jane te lidhura me to.

Nuk rezulton qe te kete subjekte / persona te trete qe te kene pretendime mbi pasurite e shoqerise dhe/ose kuotat ne shitje.

Cdo detyrim i njohur i shoqerise Panda Consulting shpk eshte i regjistruar rregullisht ne pasqyrat e saj financiare dhe nuk ka detyrime te tjera te fshehura te shoqerise per te cilen bleresi si ortak te jete ne dijeni;

Shitësi detyrohet të dorëzojë vec listes se aseteve (inventarit të makinerive dhe sendeve të luajtshme) edhe të gjithë dokumentacionin origjinal të akteve themeluese, të licensave profesionale, të akteve të Tatimeve, si dhe të gjitha faturat tatimore me të cilat është shitur malli apo është blerë malli ndaj të tretëve deri ne daten e nenshkrimit te kesaj kontrate.

Neni 5 - Transferimi i titullit te pronesise mbi kuotat

Transferimi i pronesise se pjesemarrjes objekt i kesaj kontrate shitje, nga shitesi tek bleresi, do te behet me lidhjen e kesaj kontrate. Bleresi me lidhjen e kesaj kontrate do te gezoje te gjitha te drejtat tij si ortak ligjor i 50% te pjesemarrjes ne kapitalin e shoqerise si dhe do te perballoje teresisht te gjitha detyrimet e lidhura me pronesine e kesaj pjesemarrje. Me nenshkrimin e kesaj kontrate dhe regjistrimin e saj ne Regjistrin Tregtar prane QKB, Bleresi ka te drejte te tjetersoje pjeserisht apo teresisht pjesemarrjen objekt i kesaj kontrate.

Neni 6 - Dispozitë tranzitore

Çdo kontratë qiraje, pune dhe/ose cdo kontrate apo akt tjetër ligjor, i nënshkruar nga shoqëria "Panda Consulting" shpk para hyrjes në fuqi të kësaj kontrate vijon të jetë në fuqi, derisa palët kontraktuese të vendosin ndryshe.

Neni 6 - Hyrja në fuqi

Kjo kontratë shitjeje e pjesemarrjes ne kapitalin e shoqërisë "Panda Consulting" sh.p.k përpilohet në kater kopje autentike, e shkruar në dy fletë vetëm nga njëra anë e tyre ne kater kopje, ne gjuhen shqipe dhe hyn në fuqi ne ditën e nenshkrimit te saj, më 31/10/2018

PALËT KONTRAKTUESE

SHITËSI

Lejdon Sefa

BLERËSI

Hysni Llanaj